




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE



MIRATOHET

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

LINDITA NIKOLLA



STATUTI

I

AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE

TIRANË

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Krijimi**

Agjencia Kombëtare e Provimeve (më poshtë AKP) është person juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për arsimin. AKP-ja është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve".

#### **Neni 2**

##### **Personaliteti juridik, selia dhe vendndodhja**

AKP-ja organizohet dhe funksionon në bazë të Kushtetutës, të Ligjit për Arsimin e Lartë, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, të Ligjit për Profesionet e Rregulluara, të VKM nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të këtij statuti. AKP-ja e ka selinë në rrugën "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë.

#### **Neni 3**

##### **Objekti i veprimtarisë**

AKP-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore, për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, të pranimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit.

## KREU II

### ORGANIZIMI

#### Neni 4

#### Detyrat

1. Agjencia Kombëtare e Provimeve kryen këto funksione kryesore:

- a) Vlerëson dhe menaxhon arritjet e nxënësve, nëpërmjet zhvillimit të provimeve kombëtare dhe vlerësimit të jashtëm, me kampionim.
- b) Kontribuon në hartimin e politikave të vlerësimit dhe të strategjive të zbatimit të tyre.
- c) Analizon dhe interpreton, sipas standardeve bashkëkohore dhe kërkesave të grupeve të interesit, rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve dhe i përpunon ato për publikim.
- d) Harton të dhënat shkollore dhe të maturës shkollore për pranimin e studentëve në shkollat e larta të vendit.
- e) Përpunon të dhënat për provimet përfundimtare të mësuesve për shkallët e karrierës.
- f) Kontribuon në hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të provimeve kombëtare dhe të sistemit të pranimeve.
- g) Krijon një sistem unik dhe transparent për përcaktimin e kandidatëve fitues në programet e studimit, sipas parimit meritë – preferencë.
- h) Analizon të dhënat e procesit dhe realizon studime për përmirësimin e sistemit të pranimeve në arsimin e lartë publik dhe organizimin e provimit të shtetit.
- i) Menaxhon, zbaton dhe mbikëqyr procesin kompleks që nga testimi i njohurive teorike e praktike të mësuesve dhe të profesioneve të tjera, si gjatë periudhës së testimit, ashtu edhe gjatë ushtrimit të profesionit e të mbikëqyrjes.
- j) Digjitalizon testet e hartuara nga Komisioni i Provimit të Shtetit dhe përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë për zhvillimin e provimit të shtetit, përmes teknologjisë digjitale.
- k) Trajnon personelin organizues dhe mbikëqyrës të provimit të shtetit dhe publikon online programin orientues të këtij provimi.
- l) Bën shpalljen e rezultateve të provimit të shtetit.
- m) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet për procesin e pranimin të maturantëve në shkollat e larta dhe për organizimin e provimit të shtetit.

## Neni 5

### **Marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe grupet e interesit**

1. AKP-ja bashkëpunon me institucionet e varësisë së Ministrisë përgjegjëse për arsimin me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin e aktiviteteve.
2. AKP-ja bashkëpunon me institucionet e tjera publike dhe jopublike brenda dhe jashtë vendit për të bërë të mundur plotësimin e objektivave dhe funksioneve të saj.
3. AKP-ja organizon trajnime, takime, simpoziume, konferenca për të informuar grupet e interesit rreth provimit të shtetit, maturës shtetërore, apo rreth studimeve dhe gjetjeve të kryera.
4. AKP-ja mbledh me kujdes të dhëna të hollësishme dhe përhap praktikat e suksesshme të institucioneve dhe individëve duke e bërë këtë në mënyrë të posaçme, nëpërmjet botimeve apo faqes së saj zyrtare në internet.

## **KREU III**

### **STRUKTURA, ORGANIKA DHE PUNËSIMI**

#### **Neni 6**

##### **Organizimi i brendshëm**

Struktura dhe organika e AKP-së përcaktohen me Urdhër të Kryeministrit.

#### **Neni 7**

##### **Struktura**

1. AKP-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Struktura e AKP-së përbëhet nga:

- a) Drejtoria e Vlerësimit të Arritjeve, e cila ka në përbërje:  
Sektorin e Vlerësimit të Arritjeve.  
Sektorin e Administrimit të Testit, Analizës dhe Psikometrisë.
- b) Drejtoria e Provimeve të Shtetit.
- c) Drejtoria e Bazës së të Dhënave dhe Sistemeve, e cila ka në përbërje:  
Sektorin e Pranimeve në IALP dhe Regjistrin të Studentëve të IAL.  
Sektorin e Regjistrin të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar.  
Sektorin e Administrimit të Sistemeve.
- ç) Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.

#### **Neni 8**

##### **Drejtori**

Drejtori i AKP-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Vendimin nr.173, datë 07.03.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit".

## Neni 9

### Funksionet e drejtorit

1. Drejtori i AKP-së është autoriteti përgjegjës për drejtimin dhe organizimin e veprimtarisë së AKP-së në bazë të Kushtetutës, VKM nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", legjislacionit në fuqi, dhe të këtij statuti.
2. Drejtori i AKP-së përfaqëson AKP-në në marrëdhënie me të tretët, qofshin këta persona fizik apo juridik, vendas apo të huaj.
3. Detyrat e drejtorit të AKP-së përcaktohen në rregulloren e institucionit.

## Neni 10

### Bordi Këshillimor

1. Pranë AKP-së ngrihet dhe funksionin Bordi Këshillimor si një organ kolegjal këshillimor. Ky Bord ka për qëllim të këshillojë në hartimin dhe zbatimin e planeve afatmesme dhe afatgjata dhe të japë të gjithë ndihmën e nevojshme për realizimin e misionit dhe vizionit të institucionit.
2. Me propozim të Drejtorit të AKP-së, Bordi Këshillimor miraton statutin dhe rregulloren apo ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme të tyre.
3. Drejtori këshillohet me Bordin Këshillimor për:
  - a) Ndryshimet e mundshme në përshkrimin e vendeve të punës.
  - b) Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Botues.
4. Drejtori këshillohet me Bordin Këshillimor përpara se të dërgojë për miratim te Ministri përgjegjës për arsimin:
  - a) Planin afatgjatë të zhvillimit të AKP-së.
  - b) Planin vjetor të AKP-së.
5. Bordi Këshillimor është përgjegjës për të bashkëpunuar me drejtorin për t'u siguruar që të gjitha planet dhe vendimet strategjike që lidhen me veprimtarinë e AKP-së janë zbatuar në mënyrë efektive.

## Neni 11

### Përbërja e Bordit Këshillimor

Ministri përgjegjës për arsimin miraton përbërjen e Bordit Këshillimor.

## **Neni 12**

### **Organizimi i mbledhjeve të Bordit Këshillimor**

1. Bordi Këshillimor mblidhet të paktën 4 herë në vit në mbledhje të zakonshme.
2. Mbledhjet e zakonshme të Bordit Këshillimor thirren nga kryetari i tij ose nga drejtori i AKP-së.
3. Në mbledhjet e Bordit Këshillimor është i pranishëm drejtori i AKP-së.
4. Mbledhjet e Bordit Këshillimor zhvillohen kur janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij.
5. Mbledhjet drejtohen nga kryetari. Tematika e mbledhjes dhe materialet që do të diskutohen, u shpërndahen anëtarëve të Bordit Këshillimor të paktën pesë ditë para mbledhjes.
6. Një anëtar i Bordit Këshillimor, i caktuar nga kryetari, përgatit mbledhjet e tij, mban procesverbalin, të cilin e nënshkruajnë në mbarim të mbledhjes të gjithë anëtarët, si dhe sistemon dhe ruan materialet e Bordit Këshillimor.
7. Me kërkesën e njërit prej anëtarëve të Bordit Këshillimor në mbledhjet e tij mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë.
8. Një përmbledhje me shkrim e vendimeve të Bordit Këshillimor, u bëhet e njohur punonjësve të AKP-së.

## **Neni 13**

### **Detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit Këshillimor**

1. Kryetari i Bordit Këshillimor kryeson mbledhjet e Bordit Këshillimor. Detyrat e kryetarit të Bordit Këshillimor janë si më poshtë:
  - a) Thërret mbledhjet e Bordit Këshillimor dhe merr masa për përgatitjen dhe realizimin e tyre.
  - b) Ngarkon anëtarët e Bordit Këshillimor me detyra të veçanta në kuadrin e veprimtarisë së Bordit Këshillimor.
  - c) Miraton dhe nënshkruan vendimet e marra në konsultim me Bordin Këshillimor.
2. Detyrat e anëtarit të Bordit Këshillimor janë:
  - a) Merr pjesë në mbledhjet e Bordit Këshillimor.
  - b) Studion paraprakisht materialet të cilat do të diskutohen në mbledhjet e Bordit Këshillimor.
  - c) Jep mendim për çështje që trajtohen në mbledhjet e Bordit Këshillimor.
  - ç) Miraton dhe nënshkruan vendimet e marra nga Bordi Këshillimor.
  - d) Zbaton detyrat që i ngarkohen në kuadrin e veprimtarisë së Bordit Këshillimor.

## **Neni 14**

### **Këshilli Botues dhe detyrat e tij**

1. Këshilli botues i AKP-së ka në përbërjen e tij 5 (pesë) anëtarë.
2. Anëtarë të Këshillit Botues janë punonjësit e AKP-së me gradë më të lartë shkencore dhe veprimtari të shquar kërkimore-shkencore. Mbi bazën e këtyre kriterëve, drejtori i AKP-së, me urdhër, përcakton anëtarët e Këshillit Botues.
3. Në mbledhjen e tij të parë, pas miratimit të këtij statuti, anëtarët zgjedhin kryetarin e Këshillit Botues.
4. Në fillim të çdo viti, Këshilli Botues, i propozon drejtorit të AKP-së, një plan pune të detajuar, në të cilin përshkruhen dokumentet apo produktet e parashikuara për botim. Drejtori i AKP-së miraton planin e punës dhe merr masat e nevojshme për realizimin e botimeve.
5. Këshilli Botues përzgjedh titujt për botim dhe mbikëqyr procesin e përgatitjes së tyre.

## **Neni 15**

### **Rregullimi i marrëdhënieve të punës**

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKP-së rregullohen në bazë të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

## **Neni 16**

### **Konflikti i interesit**

Çdo punonjës i AKP-së duhet të zbatojë Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar. Punonjësit e AKP-së nuk duhet të angazhohen në veprimtari të jashtme, që pengojnë kryerjen e detyrës. Në çdo rast ato duhet të njoftojnë titullarin e institucionit për çdo veprimtari të jashtme që ata kryejnë. Çdo punonjës ka detyrimin t'u përmbahet deklaratave të angazhimit për mos përfshirje në veprimtari apo aktivitete që përbëjnë konflikt interesi.



## **Neni 17**

### **Etika dhe disiplina në punë**

Çdo punonjës i AKP-së duhet të zbatojë Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", si dhe rregullat e përgjithshme të etikës profesionale dhe disiplinës në punë sipas legjisllacionit në fuqi.

## **Neni 18**

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

Çdo punonjës i AKP-së duhet të zbatojë Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet nënligjore në fuqi. Punonjësit duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

## **Neni 19**

### **Masat disiplinore**

1. Shkelja e dispozitave të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të rregullores së brendshme të institucionit dhe të legjisllacionit shqiptar përbën shkak për përgjegjësi disiplinore dhe për marrjen e masave disiplinore.
2. Llojet e masave disiplinore dhe procedura e dhënies së masave disiplinore përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

## **KREU IV**

### **FINANCIMI**

#### **Neni 20**

##### **Financimi**

1. AKP është institucion buxhetor, që financohet nga buxheti i shtetit, i miratuar për Ministrinë përgjegjëse për arsimin.
2. AKP financohet edhe nga burime të tjera të ligjshme, të dhëna në formë donacioni sipas projekteve të ndryshme nga institucione apo nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare për veprimtari apo aktiviteteve që lidhen me misionin e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

#### **Neni 21**

##### **Asetet**

Të gjitha asetet në pronësi të AKP-së ruhen dhe administrohen në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi

#### **Neni 22**

##### **Auditimi**

Veprimtaria e AKP-së auditohet nga strukturat audituese të Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe struktura të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi.

## KREU V

### STEMA DHE VULA ZYRTARE

#### Neni 23

##### Stema dhe Vula zyrtare

1. AKP identifikohet me stemën dhe vulën e saj zyrtare.
2. Stema e AKP-së përbëhet nga Stema e Republikës dhe shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve".
3. Vulat e AKP-së kanë formën dhe elementët e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Vulat e AKP-së prodhohen, administrohen, ruhen dhe asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KREU VI

### DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 24

##### Miratimi

Drejtori i AKP-së i propozon për miratim Ministrit përgjegjës për arsimin statutin e AKP-së.

#### Neni 25

##### Ndryshimi apo shfuqizimi

Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në statutin e AKP-së bëhen me propozim të Drejtorit të AKP-së apo Bordit Këshillimor dhe me miratimin e Ministrit përgjegjës për arsimin. Statuti ndryshohet apo shfuqizohet edhe kryesisht nga Ministri përgjegjës për arsimin.

#### Neni 26

##### Hyrja në Fuqi

Ky statut hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Ministri përgjegjës për arsimin.

#### Neni 27

##### Publikimi

Përmbajtja e statutit bëhet e njohur për publikun nëpërmjet publikimit elektronik në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Provimeve.

*an. 5263/pj pzet  
dat. 20.08.2014*